
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Data: 30.06.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE PAJISJE DHE ORENDI PËR NEVOJA TË KOMANDËS
MBËSHTETËSE PËR VITIN 2025”**

LOTI 1 "BLERJE ORENDISH PËR MOBILIM"

LOTI 2 "BLERJE PAJISJESH"

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP) 39150000-8; 39711130-9;
32324100-1**

VLERA E FONDIT LIMIT: “Blerje pajisje dhe orendi për nevoja të Komandës Mbështetëse për vitin 2025” me fond limit total në vlerën 37,618,436 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 383,548.5 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë pesë) euro pa TVSH

Fondi limit i Lotit 1: "Blerje orendish për mobilim" është në vlerën 32,216,511 (tridhjetë e dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 328,471.8 (treqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një pikë tetë) euro pa TVSH

Fondi limit i Loti 2: "Blerje pajisjesh" është në vlerën 5,401,925 (pesë milion e katërqind e një mijë nëntëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH dhe 55,076.7(pesëdhjetë e pesëmijë e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) euro pa TVSH.

Shënim: Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 30.07.2025 është 98.08 lekë

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI 1 "BLERJE ORENDISH PËR MOBILIM"

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të Lotit 1**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenit 42 pika 3, nenit 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor

jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit 1 është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit 1 me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si dhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marr

shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të balanceve për vitet ushtrimore (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 (të ndryshuar) atëherë bilancet duhet të

shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar përcaktohet se: “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Në nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, përcaktohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të

tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilnaceve të tre viteve të fundit finaciare, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, më qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dorëzimi i bilanceve kontabël të konfirmuar nga autoritet tatimore kërkohet për të dëshmuar se kopja e bilancit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi është kopje e njëjtë me atë të paraqitur pranë administratës tatimore.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit 1. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; neni 42 pika 3 dhe neni 40 pika 3 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet

në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:

“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë te Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshëm dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit 1. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 7 (shtatë) punonjës, me kualifikimet si më poshtë:

1 (një) inxhinier druri, në rast se është prodhues vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

2 (dy) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

1 (një) Bojaxhi/Ilustrues për prodhime druri, nëse është prodhues vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

1 (një) shofer vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës ose me kontraktim.
- leje drejtimi, e vlefshme;

2 (dy) punonjës të thjeshtë për veprimtari ndihmëse ngarkim-shkarkim vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;

-Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi. Për punonjësit që janë kërkuar edhe me kontraktim të paraqitet kontrata përkatëse.

Shenim: Kriteri nr.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkon të dëshmojë nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi.

Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional, për stafin teknik të mesëm të kërkuar referuar Vendimit nr. 514 datë 20.9.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”, duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Per Stafin teknik kryesor të kërkuar i referohemi Vendimit 514 datë 20.9.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”, si më poshtë:

Punonjësit me specialitet e sipërpërmendura kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit, duke qënë se një pjesë e madhe e artikujve të kërkuara janë mobilje druri ose materiale të tjera MDF, melaminë etj, të cilat do të prodhohen/montohen/asemblohen sipas përmasave dhe specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Ngjyra e mobiljeve është një element që nuk është përfshirë në specifikimet teknike, pasi kjo do të përcaktohet nga Autoriti Kontraktor përfitues në momentin e realizimit, e cila do të jetë në varësi të preferencave të këtij autoriteti me qëllim përshtatjen e mobiljeve me amjentet ku do të vendosen. Argumentimi për stafin e kualifikuar të kërkuar për realizimin e objektit të prokurimit si më poshtë:

Grupi-njësi (Profesioni)

“Inxhinierë industrial dhe prodhimi” Kodi i profesionit: 2141

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Inxhinierë industrial dhe prodhimi”, niveli i katërt i kompetencës në LKP.

Inxhinieri industrial dhe i prodhimit, studion, dizajnon programe për koordinimin e veprimtarive prodhuese dhe vlerëson nëse janë kosto efektive dhe të sigurta. Ai organizon dhe mbikëqyr procesin e prodhimit me qëllim nxjerrjen e produktit me cilësi të lartë, duke përdorur metodat efektive dhe me kosto të ulët, ndërsa redukton impaktin e dëmshëm tek mjedisi.

Funksionet kryesore

Inxhinierët industrial dhe të prodhimit kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Studiojnë dhe dizajnojnë sisteme të reja ergonomike të projektimit të punës dhe procese prodhimi për produkte të reja ose për të përmirësuar ato ekzistuese;
- b) Studiojnë strukturat organizative dhe informacionet e projektit për të përcaktuar funksionet dhe përgjegjësitë e punonjësve dhe për të identifikuar zonat ku nevojitet dublimi i punëtorëve;
- c) Krijojnë programe të matjes së punës së punëtorëve dhe analizojnë kampionë të pjesëve të punës për përcaktuar standardet e përdorimit të punës në tërësi (normat e punës);
- d) Organizojnë procesin e hapjes dhe mbylljes së veprimtarisë prodhuese, për të garantuar sa më pak humbje;
- e) Përcaktojnë specifikimet për prodhimin, tipin e materialeve, pajisjet, tubacionet, rrjedhën e materialeve, kapacitetet etj. për procesin industrial dhe të prodhimit;
- f) Vendosin standarde dhe politika për instalime, modifikime, kontrollin e cilësisë, testime, inspektime dhe mirëmbajtjen e impiantit në përputhje me parimet inxhinierike dhe rregullat e sigurisë në punë;
- g) Inspektojnë procesin e prodhimit dhe japin zgjidhje për problematikat e hasura gjatë tij;
- h) Bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë për të maksimizuar produktin, për të manaxhuar buxhetin, për të rekrutuar punonjës të kualifikuar, si dhe për t'i trajnuar ata;
- i) Ekzaminojnë dhe tenderojnë pajisje të reja për të garantuar cilësi të lartë me çmimin më të mirë;
- j) Drejtojnë mirëmbajtjen e ndërtesave dhe pajisjeve dhe koordinojnë kriteret për projekte të reja dhe grafikë të rinj të mirëmbajtjes.
- k) Aplikojnë teknologjitë e avancuara inxhinierike për të përmirësuar produktin;
- l) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe rregullat e mbrojtjes së mjedisit;
- m) Menaxhojnë personelin ndihmës;
- n) Rritin aftësitë e veta profesionale.

Kërkesat për punësim

- a. Arsim i lartë, Inxhinieri prodhimi;
- b. Aftësi analitike dhe komunikuese.

Informacion shtesë

Kualifikimet pasuniversitare përbëjnë avantazh në punësim dhe zhvillim karriere. Një individ mund ta nisë punën si një teknik inxhinierik për makineri prodhuese dhe industriale. Për këtë nevojitet arsim profesional para universitar. Me kryerjen e arsimit të lartë në Inxhinieri mund të punësohet si Inxhinier industrial dhe prodhimi. Me

kualifikime dhe eksperiencë pune ai mund të marrë detyra drejtuese në sektorin ku realizon projektet inxhinerike. Mund të punojë edhe në institucione shkencore e kërkimore.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

2141.01 Inxhinier druri; 2141.02 Inxhinier për regjien e lëkurëve; 2141.03 Inxhinier planimetrie 2141.04 Inxhinier prodhimi; 2141.05 Inxhinier qelqi; 2141.06 Inxhinier qeramike; 2141.07 Inxhinier robotike; 2141.08 Inxhinier sigurimi teknik; 2141.09 Inxhinier sistemesh jo informatike; 2141.10 Inxhinier stampimi; 2141.11 Inxhinier tekstilësh; 2141.12 Inxhinier efikasiteti industrial.

Shembuj të profesioneve/punësimeve të ngjashëm që klasifikohen në nivele të ndryshme të kompetencës në Listën Kombëtare të Profesioneve:

2141.01 Inxhinier druri ; 3119.06 Teknik i lartë druri ; 6210 Punonjës të pyjeve dhe sharrëxhinj
7122.03 Shtrues dyshemeje me pllaka druri; 7233.11 Montues për makina drupunuese; 7319 Punonjës të punimeve me dorë të drurit, shportave dhe të tjera të ngjashme; 7521 Punëtorë të përpunimit të drurit ; **7522 Prodhues i mobilieve dhe të tjerë të ngjashëm;** 7523 Punëtor dhe montues të makinave drupunuese; 8111.15 Punëtor armature druri në gurorë; 8172 Punëtorë të industrisë së përpunimit të drurit; 8215 Montues të prodhimeve prej druri; 9215.01 Prerës drurësh pyjor

Grupi-njësi (Profesioni)

“Prodhues i mobilieve dhe të tjerë të ngjashëm; Kodi i profesionit: 7522

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Prodhues i mobilieve dhe të tjerë të ngjashëm”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Prodhuesi i mobilieve dhe të tjerë të ngjashëm bën përpunimin e drurit për prodhime gjysmë të gatshme, si dhe përpunimin e elementëve gjysmë të gatshme (melaminës, kompensatës, MDF, fibrës, etj.) në elementë për prodhimin e dyerve, mobilieve të ndryshme, prodhimeve artistike, riparimeve, prodhimin e varkave prej druri, tapiceri etj. Prodhuesi i mobilieve mund të punësohet në ndërmarrje të ndryshme si prodhues ose në mirëmbajtje, reparte dhe mini-reparte të ndryshme prodhimi mobiliesh, të vetëpunësohet etj.

Funksionet kryesore:

Prodhuesit e mobilieve dhe të tjerë të ngjashëm kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Komunikojnë me klientët për të realizuar kërkesat e tyre;
- b) Konsultohen me kolegët për porositë e marra nga klientët, si dhe për mbarëvajtjen e punës;
- c) Kryejnë matjet e nevojshme, duke përdorur instrumentet përkatës;
- d) Bëjnë skicime të ndryshme;
- e) Bëjnë preventiv për punimet e ndryshme që realizohen në njësinë e biznesit;
- f) Parapërgatitin vendin e punës (kontrollojnë makineritë, pastrojnë vendin e punës etj.);
- g) Përpunojnë detalet prej druri me M.D.F. dhe me melamin;
- h) Përpunojnë tabelën e prerjes;
- i) Bëjnë shënimin dhe prerjen e materialit me mbishtesa;
- j) Kalojnë detalin në plan groset dhe bëjnë shkurtimin në përmasa neto;
- k) Kryejnë punime për frezim, sipas tabelës së prerjes;
- l) Kryejnë punime për birim, tabelës së prerjes;
- m) Kryejnë punime për zbusim, sipas tabelës së prerjes;
- n) Kryejnë punime për montimin në të thatë dhe me lëndë ngjitëse;
- o) Bëjnë lustrimin e produktit dhe montimin e aksesorëve;
- p) Kryejnë montimin e aksesorëve;
- q) Kryejnë punime smerilimi;
- r) Kryejnë kontrollin përfundimtar të produktit, duke përdorur vegla dore dhe pajisje të nevojshme për matje;
- s) Bëjnë paketimin e produktit;
- t) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim

- a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimiprofesional në këtë fushë;
b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë

- a. Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës punëtor. Me fitimin e eksperiencës dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin punëtor i kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një prodhues i mobilieve mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivel tekniku. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin inxhinier druri, dega përpunim druri.
- b. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në fushën e përpunimit të drurit duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.
- c. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: makinist për përpunimin e drurit, montues mobiliesh, prodhues i lëndës së sharruar, projektues për prodhimin e mobilieve, karpentier, mirëmbajtës të prodhimeve prej druri etj.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

7522.01 Aplikues kompensate;7522.02 Fuçipunues;7522.03 Gdhendës druri;7522.04 Lustrues i mobilieve;7522.05 Lyerës i mobilieve;7522.06 Mobilier;7522.07 Ndërtues karkase makine druri;7522.08 Ndërtues karrocërish druri;7522.09 Ndërtues rimorkio druri;7522.10 Prodhues bastunësh;7522.11 Prodhues bazament pianoje;7522.12 Prodhues bucelash;7522.13 Prodhues i instrumenteve muzikore prej druri (çifteli, lahuta, mandolina etj.);7522.14 Prodhues i produkteve prej druri;7522.15 Prodhues karrigesh;7522.16 Prodhues karrocash;7522.17 Prodhues këpucësh me taban druri;7522.18 Prodhues kornize fotografish/pikturash;7522.19 Prodhues kutish të ndryshme;7522.20 Prodhues llullash;7522.21 Prodhues mobiliesh të ndryshme;7522.22 Prodhues modele druri;7522.23 Prodhues pajisjesh sporti druri;7522.24 Prodhues pajisjesh zbukurimesh druri;7522.25 Prodhues shkalle druri;7522.26 Prodhues tavolinash;7522.27 Shtrues dyshemeje druri;7522.28 Tapicier;7522.29 Zdrukthëtar;7522.30 Modelues mobiliesh

Shembuj të profesioneve/punësimeve të ngjashme që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

7115 Karpentierë/zdrukthëtarë dhe të tjerë të lidhur me të;7319 Punonjës të punimeve me dorë të drurit, shportave dhe të tjera të ngjashme;7521 Punëtorë të përpunimit të drurit;7523 Punëtor dhe montues të makinave drupunuese;8172 Punëtorë të industrisë së përpunimit të drurit
8215 Montues të prodhimeve prej druri;8219 Montues të tjerë jo të klasifikuar diku tjetër

Grupi-njësi (Profesioni) “Shoferë makinash, taksish dhe furgonësh” Kodi i profesionit: 8322

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Shoferë makinash, taksish dhe furgonësh”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Shoferi i makinave, taksive dhe furgonave merret me transportin e udhëtarëve, mallrave, postës, etj. Ai drejton mjetet motorike duke u kujdesur për një transport të sigurt dhe të përshtatshëm duke zbatuar rregullat e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave. Ai mund të punësohet në kompani shërbimesh të ndryshme, shërbimesh transporti apo të vetëpunësohet.

Funksionet kryesore Shoferët e makinave, taksive dhe furgonave kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Kontrollonjë mjetin motorik para fillimit të punës; b) Drejtojnë mjetet motorike për të transportuar udhëtarë, mallra, postën etj; c) Kujdesen për transportimin sigurt të mallrave dhe udhëtarëve; d) Ndihmojnë pasagjerët për bagazhet e tyre; e) Kontrollonjë çmimet dhe pagesat për dërgesat ose dokumente që vërtetojnë dërgesat dhe grumbullojnë pagesat përkatëse; f) Përdorin pajisjet operative të telekomunikacionit për të raportuar vendndodhjen dhe disponueshmërinë e tyre; g) Ndjekin udhëzimet e kontrollit të qendrës së shoqërisë së transportit; h) Përcaktojnë rrugën më të përshtatshme për të arritur në destinacion; i) Ndihmojnë pasagjerët me aftësi të kufizuara fizike, në lëvizjet e tyre; j) Përdorin pajisje për të lehtësuar ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave

apo lëvizjen e udhëtarëve me aftësi të kufizuara fizike; k) Zbatojnë rregulloren e transportit rrugor për mallra dhe udhëtarë; l) Kryejnë shërbime të mirëmbajtjes periodike të mjetit motorik; m) Bëjnë llogaritjet dhe plotësimin e faturës përkatëse për punën e kryer; n) Pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetin e punës dhe e lënë atë në gjendje të gatshme për punë; o) Realizojnë detyra të ngjashme; p) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë; q) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim a. Të jetë e/i pajisur me leje drejtimi të nivelit të kërkuar nga organet përkatëse. b. Zakonisht kërkohet përfundimi i një shkollë profesionale në këtë fushë. c. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë fushë përbën avantazh. d. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës punëtor. Me fitimin e eksperiencës dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin punëtor i kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një drejtues i makinave, furgonëve dhe motoçikletave mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivel mbikëqyrësi. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin inxhinier mekanik. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në fushën e transportit duhet leje drejtimi për mjetin përkatës dhe regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: shofer ambulance, shofer kamionçine, shofer taksie, shoferë furgonësh etj.

“Punëtorë në miniera, ndërtim, industri e transport” Kodi i profesionit: 93

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Punëtorë në miniera, ndërtim, industri e transport”, niveli i parë i kompetencës në LKP. Punëtorët në miniera, ndërtim, industri e transport kryejnë detyra të thjeshta dhe rutinë, në miniera, gurore, ndërtimit, prodhimit, punë transporti, magazinimi, seleksionimi dhe paketimi, duke punuar me krahë, makineri dhe pajisje të pa motorizuara, apo karroca të ndryshme të tërhequra nga kafshë. Ata kryejnë shërbime ndihmëse, kryesisht punë që kërkojnë aftësi fizike dhe pak njohuri. Ata mund të punësohen në kompani të punimeve dhe shërbimeve të ndryshme, apo të vetëpunësohen.

Funksionet kryesore: Punëtorët në miniera, ndërtim, industri e transport kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Kryejnë punë krah dhe mirëmbajnë guroret; b) Kryejnë punë krah dhe mirëmbajnë miniera; c) Kryejnë punë krah dhe mirëmbajnë hekurudha; d) Kryejnë punë krah dhe mirëmbajnë diga; e) Kryejnë punë krah në ndërtim dhe mirëmbajtje rrugësh; f) Kryejnë gërmime dhe heqje dheu me lopatë, duke përdorur mjete dore apo pajisje të thjeshta; g) Kryejnë hapje të kanaleve, puseve të ujit; h) Kryejnë shembje të ndërtimeve me pajisje dore; i) Kryejnë punë krah në ndërtim; j) Kryejnë mirëmbajtje të ndërtesave të ndryshme; k) Bëjnë mbushje të kontejnerëve dhe rafteve me produktet e duhura; l) Kryejnë punë krah në industri të ndryshme; m) Kryejnë ambalazhime të ndryshme me dorë; n) Seleksionojnë materiale të ndryshme në vendet e grumbullimit të tyre; o) Ndezin zjarr dhe ndihmojnë në impiante të ngrohjes së ujit; p) Punojnë me karroca dhe pajisje të tjera të pa motorizuara për ngarkim-shkarkim mallrash të ndryshme; q) Drejtojnë dhe punojnë me karroca të ndryshme të tërhequra nga kafshët; r) Ngarkojnë dhe shkarkojnë materiale ndërtimi; s) Ngarkojnë dhe shkarkojnë mallra të ndryshme në anije, në avion, në kamionë, në pajisjet frigoriferike, apo magazina të ndryshme etj; t) Sistemojnë dhe paketojnë mall për transport; u) Realizojnë detyra të ngjashme; v) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë; ë) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim

- a. Zakonisht kërkohet përfundimi i arsimit të detyruar.
- b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

“Punëtorë ngarkim-shkarkimi” Kodi i profesionit: 9333

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Punëtorë ngarkim-shkarkimi”, niveli i parë i kompetencës në LKP.

Punëtori ngarkim-shkarkimi zhvendos, ngarkon dhe shkarkon mallra të ndryshme, me krahë dhe pajisje të thjeshta. Ai gjithashtu mbart, ngarkon dhe shkarkon mobilie dhe të sendeve të tjera të ngjashme shtëpiake. Ai ngarkon dhe shkarkon mallra prej anijeve, avionëve, vagonëve si edhe në magazina të ndryshme.

Funksionet kryesore Punëtorët e ngarkim-shkarkimit kryejnë një pjesë apo tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

a) Paketojnë orendi shtëpiake apo mobilie zyrash, pajisje dhe mallra të tjera të ngjashme të cilat duhet të transportohen nga një vend në tjetrin;

b) Transportojnë mallra për t'u ngarkuar ose shkarkuar nga furgonë, kamionë, vagonë, anije, apo avionë;

c) Ngarkojnë dhe shkarkojnë drithëra, qymyr, rërë dhe mallra të ngjashme duke i vendosur ato në mjete transportuese si konvejerë apo tuba shkarkimi etj;

d) Lidhin tubat midis gypave kryesore të instalimit në breg të cisternave, depozitave dhe anije të tjera për të ngarkuar dhe shkarkuar naftë, gaze të lëngshëm dhe lëngje të tjera;

e) Transportojnë dhe bëjnë stivë mallra në depo dhe ndërtesa të ngjashme; f) Ndajnë dhe klasifikojnë ngarkesa para ngarkimit dhe shkarkimit;

g) Kryejnë punë të tjera të ngjashme si këto;

h) Zbatojnë rregullat në mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve;

i) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës.

Kërkesat për punësim

Nuk kërkohet ndonjë kualifikim formal; trajnimi dhe eksperiencia merren gjatë punës. a. Nëse ngarkoni e shkarkoni mallra e bagazhe prej avionëve atëherë duhet të merrni trajnime të veçanta, posaçërisht të lidhura me këtë profesion. b. Duhet pasur shikueshmëri dhe dëgjim shumë i mirë. Informacion shtesë

Individi mund të punësohet në kompani transporti për mallra ndërtimi me kamionë me anije apo me tren. Ata që mund të punësohen në industrinë e transportit me avionë duhet të marrin dëshmi apo garanci për figurë të pastër të personit. Gjithashtu një treg i mirë i punësimeve në këtë profesion janë kompanitë e riciklimit të mbetjeve, magazinat dhe tregjet e mëdha ushqimore, si edhe frigoriferët e mëdhenj të cilët ruajnë mallra në temperatura të caktuara për një kohë të gjatë. Pas fillimit të punës mund të merret eksperiencë e mirë për të ecur në karrierë si përgjegjës i brigadës së punëtorëve të ngarkim shkarkimit.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve: 9333.01 Punëtor ngarkim-shkarkimi mbetjesh urbane;9333.02 Punëtor ngarkim-shkarkimi për materiale ndërtimi;9333.03 Punëtor ngarkim-shkarkimi;9333.04 Punëtorë ngarkim-shkarkimi mallrash;9333.05 Punëtor ngarkim-shkarkimi mobiliesh;9333.06 Punëtor ngarkim-shkarkimi në anije;9333.07 Punëtor ngarkim-shkarkimi në avion;9333.08 Punëtor ngarkim-shkarkimi në kamionë ;9333.09 Punëtor ngarkim-shkarkimi në pajisjet frigoriferike;9333.10 Punëtor ngarkim-shkarkimi në tregun ushqimor;9333.11 Punëtor ngarkim-shkarkimi në tren

1 (një)shofer, i cili do të realizojë transportin e mallrave objekt prokurimi në objektet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor komanda Mbështetëse, i cili duhet të jetë i pajisur me lejen e drejtimit përkatëse. Punonjësit si shoferi dhe punonjësit e thjeshtë janë të domosdoshëm për transportin dhe punën ndihmëse (ngarkim- shkarkim) që do të kryhet përgjatë të gjithë proceseve të zbatimit të kontratës. Duke qënë se mjetet e transportit mund të jenë edhe me qera, përveçse në pronësi, është gjykuar e arsyeshme që shoferi mund të diponohen edhe me kontraktim.

Këto mallra, në pjesën më të madhe të tyre nuk gjenden lirisht në treg me përmasat dhe specifikimet që kërkohen nga Autoriteti Kontraktor, pra kjo kontrate ka si procese prodhimin ose porosinë, e cila bëhet sipas Specifikimeve Teknike tek një prodhues, montimin ose asamblimin e mobiljeve, transportin dhe vendosjen e tyre në ambientet e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Ky numër punonjësish është minimale që operatori ekonomik ofertues, jo vetëm prodhues por edhe tregëtues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit Kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësor, të qëndrueshme dhe jetëgjatë, të punuara në përputhje të plotë me sipecifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në

dokumentet e tenderit. Numri i punonjësve të kërkuar më sipër është minimal dhe është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, objektet ku do të kryhet furnizimi, vendosja/ monitimi dhe kolaudimi i mallrave objekt prokurimi si dhe afatin e lëvritit të mallit.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike të prodhuesit për të gjitha artikujt objekt prokurimi të lotit 1. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet për transportin e mallrave	1 (një)	Pronësi / Me qera / Huapërdorje

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit/ (per mjetet qe kane lejen e qarkullimit te vjeter)

b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë, ose të huapërdorjes (sipas rastit).

Shenim: Kriteri nr.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik që kualifikohet i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se kanë mjete në dispozicion dhe se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi, në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Ky kriter është vendosur si siguri, që operatori ekonomik do të kryejë shërbimin e transportit në kohë me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për minimumi 1 mjet është vendosur duke patur në konsideratë vendin e dorëzimit të mallit objekt prokurimi, pranë Autoritetit Kontraktor Komanda Mbështetëse, me adresë: Rr. “Faik Kulla” dhe afatin e lëvrimit të mallit që është 2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- a) ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- b) ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- c) ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Argumentimi: Kjo lërkesë është në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

ISO 45001 ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai siguron një kornizë për organizatat për të menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën. Përfitimet e këtij kualifikimi; Kuadri për të menaxhuar në mënyrë sistematike rreziqet; Ulja e incidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës; Përkushtim i demonstruar për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

6. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 1 vjeçare të garancisë së mallrave objekt prokurimi të lotit 1, nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli i lëvruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi ose montimi të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë nga operatori ekonomik.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi të Lotit 1 do të jenë të reja, të përdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambjentet e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Shënim: Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se ofertuesi nuk plotëson këto kritere për të gjitha lotet ku ka ofertuar, OE ofertues kualifikohet vetëm në lotin/lotet në të cilin oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI 2 "BLERJE PAJISJESH"

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa

vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permblendes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të Lotit 2**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; 42 pika 3, nenin 43 pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që

bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit 1 është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar të arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të Lotit 2, duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është nën kufirin e ulët monetar, dhe sipas përcaktimeve të nenit 42 pika 3 duhet të hartohen kërkesa të veçanta të kualifikimit për secilin lot, të cilat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të lotit 2. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 42 pika 3, neni 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore

mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të lotit 2. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar dhe përcaktimeve të bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullav etë prokurimit publik” i ndryshuar, “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) punonjës, me kualifikimet si më poshtë:

1(një) specialist për sisteme ngrohje/ftohje kondicionimi vërtetuar me:

-kontratën individuale të punës;
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

1 (një) shofer vërtetuar me:

-kontratën individuale të punës ose me kontraktim.
-leje drejtimi, e vlefshme;

1 (një) punonjës të thjeshtë/ për veprimtari ndihmëse (ngarkim- shkarkim) gjatë proceseve të punës vërtetuar me:

-kontratën individuale të punës;

-Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi. Për punonjësit që janë kërkuar edhe me kontraktim të paraqitet kontrata përkatëse.

Shënim: Kriteri nr.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik që kualifikohet i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer

veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkon të dëshmojë nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi. Duke vlerësuar faktin që furnizimi me mallrat objekt prokurimi përfshin edhe vendosjen, montimin, kolaudimi e kondicionerëve në objektet e Komandës Mbështetëse, ka vlerësuar të nevojshme që, me qëllim garantimin e përmbushjes me sukses të kontratës, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin e kualifikuar:

Diplome/dëshmi/certifikate kualifikimi profesional, për stafin teknik të mesëm të kërkuar referuar Vendimit nr. 514 datë 20.9.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”, duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Per Stafin teknik kryesor të kërkuar i referohemi Vendimit 514 datë 20.9.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”, si më poshtë:

1 (një) specialist për sisteme ngrohje/ftohje kondicionimi që lidhet drejtëpërdrejtë me furnizim/vendosjen e kondicionerëve; numri i kondicionerëve që do të furnizohen dhe montohen në objekte (ndërtesa) të Komandës Mbështetëse është 50 copë, për rrjedhojë kërkesa për 1 specialist të tillë është e domosdoshme.

Grupi-njësi (Profesioni)

“Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse”

Kodi i profesionit: 7127

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe Sistemeveftohëse -ngrohëse”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Instaluesi dhe riparuesi i kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse merret me parapërgatitjen, montimin dhe instalimin e kondicionerëve, kaldajave, paneleve diellore, çillërave (sistemeve ngrohëse-ftohëse), si dhe kryen riparime apo punime mirëmbajtjeje në sistemet e ngrohje-ftohjes. Ai mund të punësohet në kompani të shërbimeve të ndërtimit apo të vetëpunësohet.

Funksionet kryesore:

Instaluesit dhe riparuesit e kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse, kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Marrin porosinë nga klienti;*
- b) Bëjnë preventivin sipas porosisë së dhënë nga klienti;*
- c) Konsultohen me kolegët për punimet që do të kryhen;*
- d) Interpretojnë projektet, vizatimet apo specifikimet e tjera;*
- e) Kontrollojnë vendin ku do të kryejnë montimin e pajisjet ftohëse-ngrohëse për të kryer modifikimet e duhura;*
- f) Parapërgatitin bazën materiale dhe mjetet e punës që do t'iu duhen për të kryer punimet;*
- g) Bëjnë shtrirjen e tubave të bakrit në dyshe dhe mure (në rastin e kaldajës, çillerit, apo paneleve diellore) sipas projekteve përkatëse;*
- h) Montojnë tubat e bakrit në pajisjen e brendshme (kondicionerit, kaldajës, çillerit).*
- i) Montojnë pajisjen mbajtëse të brendshme;*
- j) Bëjnë lidhjen e kabullit në pajisjen e brendshme (kondicionerit, kaldajës, çillerit).*
- k) Bëjnë montimin e pajisjes së brendshme;*
- l) Bëjnë montimin e bazave të motorit apo të panelit diellor;*
- m) Montojnë motorin e kondicionerit, kaldajën apo panelin diellor;*
- n) Bëjnë lidhjen e tubave dhe kablove në pajisje, sipas llojit dhe dimensioneve të tyre;*
- o) Përgatitin formën konike të kokave të tubave të bakrit;*
- p) Montojnë komponentët e pajisjeve ngrohëse-ftohëse në një sistem;*
- q) Kryejnë instalimet e duhura;*
- r) Diagnostikojnë sistemin për gabime të mundshme dhe bëjnë korrigjimet e duhura;*
- s) Bëjnë kontrollin për gaz apo ujë, sipas llojit të pajisjes;*
- t) Bëjnë matjen e presionit me manometër;*
- u) Bëjnë plotësimin e diferencave të humbjes;*
- v) Bëjnë hapjen e gazit tek kondicioneri sipas trashësisë së tubave;*
- ë) Kryejnë hapjen e ujit tek kaldaja apo paneli diellor;*
- x) Bëjnë vendosjen e pajisjeve në punë dhe kontrollin përfundimtar të tyre;*
- y) Kryejnë provën e mirëfunksionimit të pajisjes ngrohëse-ftohëse dhe sistemit të instaluar;*
- z) Kryejnë riparime të komponentëve të tillë si: kompresorë, motor, kondensator, si dhe riparime të tjera në sistemin e instaluar për ngrohje-ftohje;*
- aa) Kryejnë pastrimin periodik të pajisjeve;*
- bb) Realizojnë detyra të tjera të ngjashme;*
- cc) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë;*
- dd) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.*

Kërkesat për punësim

a. Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional për këtë profesion.

b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë

Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës. Me fitimin e eksperiencës dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin punëtor i kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një instalues dhe riparues i kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivel teknik. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin inxhinierit. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në këtë fushë duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si

person fizik apo juridik, sipas rastit. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: instalues të kaldajave, instalues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse - ngrohëse, instalues të paneleve diellore, riparues, mirëmbajtës të kaldajave etj.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

7127.01 Instalues të kaldajave ;7127.02 Instalues të paneleve diellore ;7127.03 Instalues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse ngrohëse ;7127.04 Instalues të sistemeve ftohëse ;7127.05 Riparues/mirëmbajtës të kaldajave ;7127.06 Riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse ;7127.07 Riparues të paneleve diellore ;7127.08 Riparues të sistemeve ngrohëse-ftohëse.

Grupi-njësi (Profesioni) “Shoferë makinash, taksish dhe furgonësh” Kodi i profesionit: 8322

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Shoferë makinash, taksish dhe furgonësh”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Shoferi i makinave, taksive dhe furgonave merret me transportin e udhëtarëve, mallrave, postës, etj. Ai drejton mjetet motorike duke u kujdesur për një transport të sigurt dhe të përshtatshëm duke zbatuar rregullat e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave. Ai mund të punësohet në kompani shërbimesh të ndryshme, shërbimesh transporti apo të vetëpunësohet.

Funksionet kryesore Shoferët e makinave, taksive dhe furgonave kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Kontrollonjë mjetin motorik para fillimit të punës; b) Drejtojnë mjetet motorike për të transportuar udhëtarë, mallra, postën etj; c) Kujdesen për transportimin sigurt të mallrave dhe udhëtarëve; d) Ndihmojnë pasagjerët për bagazhet e tyre; e) Kontrollonjë çmimet dhe pagesat për dërgesat ose dokumente që vërtetojnë dërgesat dhe grumbullojnë pagesat përkatëse; f) Përdorin pajisjet operative të telekomunikacionit për të raportuar vendndodhjen dhe disponueshmërinë e tyre; g) Ndjekin udhëzimet e kontrollit të qendrës së shoqërisë së transportit; h) Përcaktojnë rrugën më të përshtatshme për të arritur në destinacion; i) Ndihmojnë pasagjerët me aftësi të kufizuara fizike, në lëvizjet e tyre; j) Përdorin pajisje për të lehtësuar ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave apo lëvizjen e udhëtarëve me aftësi të kufizuara fizike; k) Zbatojnë rregulloren e transportit rrugor për mallra dhe udhëtarë; l) Kryejnë shërbime të mirëmbajtjes periodike të mjetit motorik; m) Bëjnë llogaritjet dhe plotësimin e faturës përkatëse për punën e kryer; n) Pastrojnë dhe mirëmbajnë mjetin e punës dhe e lënë atë në gjendje të gatshme për punë; o) Realizojnë detyra të ngjashme; p) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë; q) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim a. Të jetë e/i pajisur me leje drejtimi të nivelit të kërkuar nga organet përkatëse. b. Zakonisht kërkohet përfundimi i një shkollë profesionale në këtë fushë. c. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë fushë përbën avantazh. d. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

Informacion shtesë Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës punëtor. Me fitimin e eksperiencës dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin punëtor i kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një drejtues i makinave, furgonëve dhe motoçikletave mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivel mbikëqyrësi. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin inxhinier mekanik. Për të zhvilluar aktivitete privat (vetëpunësim) në fushën e transportit duhet leje drejtimi për mjetin përkatës dhe regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: shofer ambulance, shofer kamionçine, shofer taksie, shoferë furgonësh etj.

“Punëtorë në miniera, ndërtim, industri e transport” Kodi i profesionit: 93

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Punëtorë në miniera, ndërtim, industri e transport”, niveli i parë i kompetencës në LKP. Punëtorët në miniera, ndërtim, industri e transport kryejnë detyra të thjeshta dhe rutinë, në miniera, gurorë, ndërtimit, prodhimit, punë transporti, magazinimi, seleksionimi dhe paketimi, duke punuar me krahë, makineri dhe pajisje të pa motorizuara, apo karroca të ndryshme të tërhequra nga kafshë. Ata kryejnë shërbime ndihmëse, kryesisht punë që kërkojnë aftësi fizike dhe pak njohuri. Ata mund të punësohen në kompani të punimeve dhe shërbimeve të ndryshme, apo të vetëpunësohen.

Funksionet kryesore: Punëtorët në miniera, ndërtim, industri e transport kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Kryejnë punë krah dhe mirëmbajnë guroret; b) Kryejnë punë krah dhe mirëmbajnë miniera; c) Kryejnë punë krah dhe mirëmbajnë hekurudha; d) Kryejnë punë krah dhe mirëmbajnë diga; e) Kryejnë punë krah në ndërtim dhe mirëmbajtje rrugësh; f) Kryejnë gërmime dhe heqje dheu me lopatë, duke përdorur mjete dore apo pajisje të thjeshta; g) Kryejnë hapje të kanaleve, puseve të ujit; h) Kryejnë shembje të ndërtimeve me pajisje dore; i) Kryejnë punë krah në ndërtim; j) Kryejnë mirëmbajtje të ndërtesave të ndryshme; k) Bëjnë mbushje të kontejnerëve dhe rafteve me produktet e duhura; l) Kryejnë punë krah në industri të ndryshme; m) Kryejnë ambalazhime të ndryshme me dorë; n) Seleksionojnë materiale të ndryshme në vendet e grumbullimit të tyre; o) Ndezin zjarr dhe ndihmojnë në impiante të ngrohjes së ujit; p) Punojnë me karroca dhe pajisje të tjera të pa motorizuara për ngarkim-shkarkim mallrash të ndryshme; q) Drejtojnë dhe punojnë me karroca të ndryshme të tërhequra nga kafshët; r) Ngarkojnë dhe shkarkojnë materiale ndërtimi; s) Ngarkojnë dhe shkarkojnë mallra të ndryshme në anije, në avion, në kamionë, në pajisjet frigoriferike, apo magazina të ndryshme etj; t) Sistemojnë dhe paketojnë mall për transport; u) Realizojnë detyra të ngjashme; v) Mbikëqyrin punëtorët e tjerë; ë) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim

a. Zakonisht kërkohet përfundimi i arsimit të detyruar.

b. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

“Punëtorë ngarkim-shkarkimi” Kodi i profesionit: 9333

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Punëtorë ngarkim-shkarkimi”, niveli i parë i kompetencës në LKP.

Punëtori ngarkim-shkarkimi zhvendos, ngarkon dhe shkarkon mallra të ndryshme, me krahë dhe pajisje të thjeshta. Ai gjithashtu mbart, ngarkon dhe shkarkon mobilie dhe të sendeve të tjera të ngjashme shtëpiake.

Ai ngarkon dhe shkarkon mallra prej anijeve, avionëve, vagonëve si edhe në magazina të ndryshme.

Funksionet kryesore Punëtorët e ngarkim-shkarkimit kryejnë një pjesë apo tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

a) Paketojnë orendi shtëpiake apo mobilie zyrash, pajisje dhe mallra të tjera të ngjashme të cilat duhet të transportohen nga një vend në tjetrin;

b) Transportojnë mallra për t'u ngarkuar ose shkarkuar nga furgonë, kamionë, vagonë, anije, apo avionë;

c) Ngarkojnë dhe shkarkojnë drithëra, qymyr, rërë dhe mallra të ngjashme duke i vendosur ato në mjete transportuese si konvejerë apo tuba shkarkimi etj;

d) Lidhin tubat midis gypave kryesore të instalimit në breg të cisternave, depozitave dhe anije të tjera për të ngarkuar dhe shkarkuar naftë, gaze të lëngshëm dhe lëngje të tjera;

e) Transportojnë dhe bëjnë stivë mallra në depo dhe ndërtesa të ngjashme; f) Ndajnë dhe klasifikojnë ngarkesa para ngarkimit dhe shkarkimit;

g) Kryejnë punë të tjera të ngjashme si këto;

h) Zbatojnë rregullat në mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve;

i) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës.

Kërkesat për punësim

Nuk kërkohet ndonjë kualifikim formal; trajnimi dhe eksperiencia merren gjatë punës. a. Nëse ngarkoni e shkarkoni mallra e bagazhe prej avionëve atëherë duhet të merrni trajnime të veçanta, posaçërisht të lidhura me këtë profesion. b. Duhet pasur shikueshmëri dhe dëgjim shumë i mirë. Informacion shtesë

Individi mund të punësohet në kompani transporti për mallra ndërtimi me kamionë me anije apo me tren. Ata që mund të punësohen në industrinë e transportit me avionë duhet të marrin dëshmi apo garanci për figurë të pastër të personit. Gjithashtu një treg i mirë i punësimeve në këtë profesion janë kompanitë e riciklimit të mbetjeve, magazinat dhe tregjet e mëdha ushqimore, si edhe frigoriferët e mëdhenj të cilët ruajnë mallra në temperatura të caktuara për një kohë të gjatë. Pas fillimit të punës mund të merret eksperiencë e mirë për të ecur në karrierë si përgjegjës i brigadës së punëtorëve të ngarkim shkarkimit. Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve: 9333.01 Punëtor ngarkim-shkarkimi mbetjesh urbane; 9333.02 Punëtor ngarkim-shkarkimi për materiale ndërtimi; 9333.03 Punëtor ngarkim-shkarkimi; 9333.04 Punëtorë ngarkim-shkarkimi mallrash; 9333.05 Punëtor ngarkim-shkarkimi mobilie; 9333.06 Punëtor ngarkim-shkarkimi në anije; 9333.07 Punëtor ngarkim-shkarkimi në avion; 9333.08 Punëtor ngarkim-shkarkimi në kamionë; 9333.09 Punëtor ngarkim-shkarkimi në pajisjet frigoriferike; 9333.10 Punëtor ngarkim-shkarkimi në tregun ushqimor; 9333.11 Punëtor ngarkim-shkarkimi në tren

Punonjësit si shoferi dhe punonjësit e thjeshtë janë të domosdoshëm për transportin dhe punën ndihmëse (ngarkim- shkarkim) që do të kryhet përgjatë të gjithë proceseve të zbatimit të kontratës. Duke qenë se mjetet e transportit mund të jenë edhe me qera, përveçse në pronësi, është gjykuar e arsyeshme që shoferi mund të diponohet edhe me kontraktim. Kjo krijon bindjen e Autoritetit Kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton produkte përfundimtare cilësor, të qëndrueshme dhe jetëgjatë, të punuara në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit.

Numri i punonjësve të kërkuar më sipër është minimal dhe është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, objektet ku do të kryhet furnizimi, vendosja/ monitimi dhe kolaudimi i mallrave objekt prokurimi si dhe afatin e lëvrimit të mallit.

3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike të prodhuesit për të gjitha artikujt objekt prokurimi të lotit 2. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
-------	-------	---------

Mjet për transportin e mallrave	1 (një)	Pronësi / Me qera / Huapërdorje
---------------------------------	---------	---------------------------------

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe çertifikata e pronësisë së mjetit/ (per mjetet qe kane lejen e qarkullimit te vjeter)
- b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe çertifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë, ose të huapërdorjes (sipas rastit).

Shenim: Kriteri nr.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik që kualifikohet i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se kanë mjete në dispozicion dhe se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi, në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Ky kriter është vendosur si siguri, që operatori ekonomik do të kryejë shërbimin e transportit në kohë me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për minimumi 1 mjet është vendosur duke patur në konsideratë vendin e dorëzimit të mallit objekt prokurimi, pranë Autoritetit Kontraktor Komanda Mbështetëse, me adresë: Rr. “Faik Kulla” dhe afatin e lëvrimit të mallit që është 2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Argumentimi: Kjo lërkesë është në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”. Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku përcaktohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm çertifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

ISO 45001 ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai siguron një kornizë për organizatat për të menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën. Përfitimet e këtij kualifikimi; Kuadri për të menaxhuar në mënyrë sistematike rreziqet; Ulja e incidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës; Përkushtim i demonstruar për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

6. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën e garancisë së mallrave objekt prokurimi të Lotit 2 nga data e dorëzimit të mallit, sipas afatit të përcaktuar në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli i lëvruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi ose montimi të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë nga operatori ekonomik.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi të Lotit 2 do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambjentet e Aautoritetit Kontraktor përfitues.

Shënim: Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se ofertuesi nuk plotëson këto kritere për të gjitha lotet ku ka ofertuar, OE ofertues kualifikohet vetëm në lotin/lotet në të cilin oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues Komanda Mbështetëse, për Lotin 1 bazuar në specifikimet teknike të unifikuara nga Organi Qendror Blerës, të publikuara në faqen zyrtare të Operatorit Blerjeve të Përqendruara www.obp.al, dhe specifikimet teknike për Lotin 2 janë hartuar dhe miratuar nga grupi i punës së Komandës Mbështetëse, pasi artikujt objekt prokurimi nuk ndodhen në katalogët e OBP, në përputhje me nenin 36 të ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to për të dy lotet: Hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Komanda Mbështetëse.

Specifikimet teknike të mallrave që duhet të ofrohen: Mirëmbajtja full risk sipas rekomandimeve të prodhuesve përkatës të pajisjeve dhe orendive që do të jenë në përdorim në disa ambiente të Komandës Mbështetëse sipas përshkrimit të mëposhtëm të shërbimit. Shërbimet që duhet të ofrohen, **Në 2 faza: Së pari: “Mirëmbajtje parandaluese”,** (artikujt të cilët sipas prodhuesit kanë nevojë mirëmbajtje të

vazhdueshme dhe sipas kriterëve të përcaktuar që nga dalja nga magazina e prodhuesit, të tillë, kondicioner, televizor, frigorifer, paisje tjera të ngjashme, si dhe ato të karakterit të performancës në bazë të përdorimit e katalogut)

1. **Mirëmbajtja parandaluese:** Përcaktimi i çmimeve sipas artikujve ka patur parasysh edhe që ky shërbim duhet të kryhet periodikisht sipas rekomandimeve të prodhuesit, me qëllim parandalimin e defekteve që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur sistemin e pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të çdo pajisjeje, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjeve, (në bazë të katalogut të prodhuesit).

2. **Së dyti: “Mirëmbajtje korrigjuese”,** (artikujt të cilët përfshihen në montim, zhvendosje, çmontim, si dhe për një arsye objektive kërkohet ndërhyrja e prodhuesit apo e subjektit shitës i produktit).

Mirëmbajtja korrigjuese: Vlerësimi dhe parametrat e përcaktuar sipas specifikimeve teknike për këtë shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, identifikimin e shkaqeve, eliminimin e shkaqeve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë sipas rekomandimeve të prodhuesit. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimin. Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me autorizimin e prodhuesit për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes për pajisjet përkatëse. Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korrigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së personelit që do jetë përdoruesi fundor i produktit, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me çdo mos përputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontroleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, i Kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek Kontraktuesi mbi gjendjen dhe ecurinë e gjithë aktivitetit të orendive e sidomos paisjeve të cilat kanë specifika përdorimi të veçanta.

LOTI 1 "BLERJE ORENDISH PËR MOBILIM"

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR ORENDIT PËR MOBILIM SIPAS KATALOGUT TË OBP

Objekt i këtij katalogu është përcaktimi i specifikimeve teknike për çdo artikull në funksion të përzgjedhjes nga ana e autoriteteve kontraktore, sipas nevojave të tyre.

Specifikimet teknike të përgjithshme të produkteve, kanë të përcaktuara karakteristikat e produktit, përshkrimin e produktit, kërkesat cilësore, sasiore, ambalazhimin, etiketimin.


Specifikimet teknike përshkruajnë saktë dhe në mënyrë të plotë, duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoriteteve Kontraktore dhe duke iu referuar gjendjes së tregut për secilat nga këto kërkesa, Specifikimet teknike janë hartuar me qëllim që të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë palët e interesuara.


Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ose ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

Nr.	Emërtimi i artikujve	Përshkrimi i artikujve	Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi)	Njësi a matëse
2	Reception ne formë U-je	Ky reception modern përmban sipërfaqe te melaminuar që i rezistojnë gërvishtjeve dhe njollave nga lëndët e lëngshme. Trashësia e pllakës së përdorur 18 mm. Syprina është me panele laminati ngjyrë argjendi që përputhet me xokolen e përparme të mobiljes duke theksuar rifiniturën. Katër unaza metalike gjenden në sipërfaqe për të mbajtur telat/kabllo të fshehura dhe të organizuara. Karakteristika unike e kësaj tryeze është syprina e qelqit të temperuar që duket se noton mbi sipërfaqe dhe mbështetet nga këmbëza prej metali ngjyrë argjendi. Kjo tryezë përbëhet nga dy tavolina të drejta 120cm, dy tavolina të harkuara dhe një kthim tavolinë kthimi që mund të vendosen në të dy anët. Mobilja e receptionit te jete e paisur me sirtare. Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN,e njëvlefshme ose e përditësuar),SSH EN 13721:2004	<i>Tavolinat e drejta:</i> Min 120x80x105cm <i>Tavolina me hark:</i> Min 80x80x105cm <i>Tavolina e kthimit</i> Min 80x80x75 cm, Dimensione: Min 280x200x105 cm Max 300x220x120 cm	Copë


6	Dollap metalik me kanata rrëshqitëse	Dollap metalik me kanata rrëshqitëse duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korrozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Dollapi është me kanata rrëshqitëse. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004	120 x 45 x 200 cm	Copë
---	---	--	----------------------	------

15	Dollap me dy kanata	Materiali i skeletit dhe kanatet do të jetë prej melaminë, me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve do të jenë të veshura me PVC me trashësi jo më të vogël se 1 mm, e ngjashme me ngjyrën e melaminës. Kanatet do të montohen me mentesha metalike që lejojnë hapjen e lirë të kanateve. Sergjenet do jenë prej materiali melaminë me trashësi 2.5 cm. Materiali të ketë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. të jenë të veshura (bordura) me material plastik PVC. Kanatet të mbyllen me çelës. Pjesa e brendshme të ndahet në minimum 5 (pesë) hapësira me sergjene me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanateve dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004	90 x 45 x 210 cm	Copë
21	Raft metalik për arkivë	Materiali i përdorur për këmbët do të jetë profil katror 30 x 30 x me spesor 1.6 deri 1.8 mm. Materiali i përdorur për vendosjen (sergjenat) e dosjeve do të jetë llamarinë e zezë me spesor 1.2 mm. Rafti do të ketë dhe një platformë melamine me shinë që do të shërbejë për një shikim të shpejtë të dosjes në vend. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004	100 x 42 x 250 cm	Copë
22	Raft metalik për dosje (arshivë)	Raftet kërkohen të jenë prej materiali metalik, me strukturë të qëndrueshme për mbajtje sasiore dokumentesh. Të jetë i ndarë me 4 sergjenë. Krahët mbajtës të jenë me vrima për vendosje raftesh horizontalë në nivele të ndryshme dhe me mbështetëse gome në pjesën fundore. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004	90 x 40 x 200 cm	Copë

25	Raft për dosje, material MDF	Raftet do të realizohen me MDF, ku në pjesën e jashtme ajo do të jetë të veshur me rimeso anigre si tavolinat e zyrës përkatëse dhe do të jenë të lyera me ngjyrë natyrale. MDF që do të përdoret do të ketë spesor 18 mm, me rimeso anigre dhe kjo do të jetë e lyer ngjyrë natyrale. Duhet te kihet kujdes ne montimin e pjesëve përbërëse, pasi nuk duhet të jenë në dukje vidat e bashkimit. Në pjesën e poshtme do të vendosen tapa fundore në mënyrë që të ketë një distancë të vogël nga dollapi me dyshemenë. Pjesa e mbrapme e dollapit do të jetë me fibër 4 mm. Kanatat prej xhami me korniza inoksi 20 x 20 mm. Xhami do jetë transparent me trashësi 4 mm. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004 	90 x 45 x 200 cm	Copë
27	Raft për dosje (etazher)	Skeleti dhe Sergjenet do jenë prej materiali Melaminë me trashësi 2.5 cm. Xokula do jetë 11 cm e lartë, e mbuluar dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë këmbëza me mekanizëm nivelues, do të ketë dy kapakë prej materiali Melaminë, me trashësi jo më të vogël se 1.8 cm që mbyllen me çelës. Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjene me lartësi të regjistrueshme. Dorezat dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali te kromuar. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004	126 x 47 x 80 cm	Copë

				
30	Raft me çelësa	Rafti do të realizohet me MDF, ku në pjesën e jashtme ajo do të jetë të veshur me rimeso anigre si tavolinat e zyrës përkatëse dhe do të jenë të lyera me ngjyrë natyrale. MDF që do të përdoret do të ketë spesor 16 deri 18 mm, me rimeso anigre dhe kjo do të jetë e lyer ngjyrë natyrale. Duhet të kihet kujdes në montimin e pjesëve përbërëse, pasi nuk duhet të jenë në dukje vidat e bashkimit. Pjesa e shpinës së dollapit do të jetë me MDF 16 deri 18 mm (për arsye të vendosjes së grepave). Duhet të jetë i ndarë në katër pjesë të barabarta, i pajisur me etiketa dhe grepa për vendosjen e çelësave, të mbyllet me çelës si dhe të ketë kapëse për tu varur në mur. Kanatat prej xhami Pajisjet e raftit janë të pajisura me dyer xhami me korniza inoksi 20 x 20 mm. Xhami do të jetë transparent, i temperuar me trashësi 4 mm. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004	100 x 23 x 140 cm	Copë

33	Raft për bibliotekën	Material druri multistrat anigre. Librari e lartë, realizuar me 2 thellësi. Pjesa e poshtme, do të ketë strukturë anësore me trashësi 16-18 mm, me përmasa lartësi 1065 mm, gjatësi 810 mm dhe gjerësi të 610 mm. Ky modul në pjesën e poshtme të lidhet me krahun përballë me një ndarje horizontale me trashësi 70 mm, gjatësi 774 mm, gjerësi 610 mm. Në pjesën e sipërme moduli të mbyllet po me një raft ndarës por me trashësi 40 mm, gjatësi 774 mm dhe gjerësi 610 mm. Shpinorja të jetë e dukshme me spesore 6-8 mm. Në mes të strukturës, për të lejuar sistemimin e librave, duhet të jetë e pajisur me një raft ndarës me përmasa gjatësi 774 mm, gjerësi 610 mm, trashësi 20 mm. Pjesa e sipërme, duhet të jetë e ndërtuar nga 2 anësore me dimensione: gjatësi 1540 mm gjerësia 505 mm, trashësia 16-18 mm. Në pjesën e sipërme moduli të mbyllet po me një raft ndarës por me trashësi 40 mm gjatësi 774 mm dhe gjerësi 505 mm. Shpinorja e dukshme të ketë trashësi 6-8 mm. Në pjesën qendrore të strukturës, për të lejuar sistemimin e librave, duhet të jetë e pajisur me tre rafte ndarës me dimensione gjatësi 774 mm, gjerësi 497 mm, trashësi 20 mm. Materiali i librarisë duhet të jetë në dru apo kompensate trajtuar kundër lagështirës dhe reflektimit të dritës. Raftet e brendshme janë të pajisur me element mbajtës të padukshme, të cilët ndihmojnë në qëndrimin e strukturës anësore, duke balancuar peshën në momentin e mbushjes me libra apo materiale të tjera zyre. Të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004 	L 81 H 260 P 50.5/61 cm	Copë
----	-----------------------------	--	-------------------------	------

				
39	Komodina dyshe (ushtari)	Materiali i përdorur do jetë melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të elementëve përbërës të jenë të veshur me material plastik PVC. Ato duhet të jenë të pajisura me një sirtar në pjesën e sipërme dhe pjesën mbajtëse të rrobave që mbyllet me dy kapakë. Komodina qëndron mbi 4 këmbë metalike me lartësi 5 cm nga toka dhe të pajisura me mekanizëm regjistruar. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njevelefshme ose e perditësuar) , SSH EN 13721:2004	60 x 40 x 80 cm	Copë

40	Komodinë zyre	Materiali i përdorur do jetë melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të elementëve përbërës të jenë të veshur me material plastik PVC. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Të plotësojë kërkesat e Standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	45 x 60 x 65 cm	Copë
50	Kasaforta sekrete	Kasaforta duhet të ketë strukturë llamarinë me trashësi jo më pak se 1.5 mm. Të ketë dy ndarje horizontale nga brenda, ku të krijohen tre hapësira. Dera të jetë e pajisur me dorezë dhe bravë automatike sekrete. Lyerja me mënyrë elektrostатike. Bazamenti të jetë jo më pak se 10 cm.	50 x 50 x 110 cm	Copë
68	Shtrat vizite për infirmierinë	Shtrati i vizitës do të ketë dimensione të përafërta 180cm x 60cm. Lartësia 75-80 cm. Sipërfaqja të jetë e përbërë nga një segment fiks dhe një segment me kënd të rregullueshëm. Pesha mbajtëse jo më pak se 100kg. Skeleti do të ndërtohet me profil metalik tubolar me seksion katror 40x40 mm me spesor jo më të vogël se 1.2 - 1.5mm. Elementët lidhës do të jenë profil tubolar me seksion 40x20 mm me spesor jo më të vogël se 1.5mm. Si mbështetje do të kemi pllakë zdrukthi të veshur me sfungjer të cilësisë së lartë, e veshur me textil.	180 x 60 x 75-80 cm	Copë

70	Karrige statike pa krahë mbështetës	Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Skeleti përbëhet prej një tubi petashuq ovale 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 mm, i cili përshkon shpinoren në dy anët e saj dhe ndenjësen. Montohen në skeletin metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Lyerja me boje elektrostатike. Tapiceria të jetë lëkurë ekologjike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 		Copë
71	Karrige statike me krahë mbështetës	Karrigia duhet të jetë me strukturë metalike, bazament mbështetës në formë U, me përmasa ndenjësja 46 cm x 47 cm, shpinorja të jetë në formë të harkuar me përmasa 60 cm x 48 cm. Gjatësia e shpinores duhet të zbrësë poshtë nivelit të ndenjësës. Përmasat e bazamentit mbështetës 57 cm x 47 cm. Lartësia totale të jetë 94 cm. Shpinorja dhe ndenjësja duhet të jenë të veshur me lëkurë ekologjike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018	60 x 40 x 80 cm	Copë


72	Karrige jo statike me krahë mbështetës	Pesha rreth 12 kg, lartësia e shpinores jo më e vogël se 90/107 cm, lartësia e ndenjësës jo më e vogël se 45/52 cm, thellësia jo më e vogël se 44 cm, gjerësia jo më e vogël se 58 cm. Me 5 rrota me bazën plastike me ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, pjesa mbështetëse imiton shpinën dhe ka fleksibilitetin e duhur për tu mbështetur, komfort, e veshur me copë ose lëkurë, me regjistrues lartësie për tu ngritur dhe ulur karrigen. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018		Copë
73	Karrige për rangun drejtues	Karrigia statike duhet të jetë me tapiceri prej lëkure origjinale natyrale kadore, me shpinore të lartë dhe rezistonte ndaj zjarrit. Shpinorja duhet të jetë e përshtatshme në pozicionet vertikalisht si dhe para e prapa. Duhet të ketë krahë anësore me tub inoksi. Thellësia e ulëses, e përshtatshme për përdorues të rritur. Bazamenti duhet të jetë metalik me 5 degëzime në formë ylli. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018		Copë

74	Karrige për kabinetet	Lartësia 85 cm kurse lartësia e ndenjës nga dyshemeja jo më pak se 44 cm. Dimensionet e ndenjës jo më pak se 40x40cm. Skeleti të realizohet nga dru ah masiv me seksion katror ose I rumbullakët, i lyer me llak për të ruajtur ngjyrën natyrale të drurit. Ndenjësja të realizohet me melaminë, sfungjer dhe stof. Në çdo rast duhet të sigurojnë një formë të harkuar. Në çdo rast do jetë e mbushur me sfungjer dhe e tapicuar me copë stofi ose lëkure. Mbështetësja të realizohet me ristela të kurbëzuara jo më pak se dy ristela me gjerësi jo më pak se 5 cm ose një e vetme me gjerësi jo më pak se 10cm. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1728:2012, SSH EN 12520:2015, SSH EN 1022:2018		Copë
75	Kolltuqe komplet (3+2+1)	Skelet druri, stil modern dhe tapiceri me lëkurë ekologjike. Mbushje me sfungjer cilësor. Modeli, seti, ngjyra, etj, do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës. Në komplet do të jenë një 3 vendesh një 2 vendesh dhe një kolltuk tek. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 13759 :2012	Divani 3-vendësh: 200x90xH90 cm; Divani 2-vendësh: 170x90xH90 cm; Kolltuku: 120x90xH90 cm;	Komplet
76	Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh)	Të jetë me skelet druri. Të jetë i dizenuar me linja të drejta të stilit modern. Me tapiceri prej lëkure ekologjike të një cilësie të lartë. Sfungjeri i përdorur të jetë cilësor. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 13759 :2012	186 x 95 x 94 cm	Copë
77	Poltron pritje njëvendësh (kolltuk 1-vendësh)	Të jetë me skelet druri. Të jetë i dizenuar me linja të drejta të stilit modern. Me tapiceri prej lëkure ekologjike të një cilësie të lartë. Sfungjeri i përdorur të jetë cilësor. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 13759 :2012	92 x 89 x 84 cm	Copë

79	Poltron rrotullues	Baza e poltronit të jetë alumin me diametër 660 mm dhe e lyer me bojë elektrostatische në 200 C ose inoks me diametër 630mm.Rrotat të jenë të përforcuar me material termoplastik (poliamide).Bazamenti të jetë i ndërtuar nga pesë këmbë metalike me rrota te lëvizshme 360 grade. E gjithë struktura e poltronit te jetemetalike.Pistoni gazit për rregullimin e lartësisë te karriges të aktivizohet me levë që ndodhet poshtë dhe ne anën e djathte te ndenjësës. Mekanizmi revokimit te ndenjësës të jetë i përberë nga alumin dhe të lejojë tërheqjen e sinkronizuar te ndenjësës nga 11 gradë dhe mbështetësen e shpinës në 18 gradë Rregullimi të arrihet duke tërhequr levën e vendosur më poshtë dhe në qendër të objektit. Të jetë gjithashtu e mundur për të rregulluar thellësinë e ndenjësës qe të përshtatet me përmasat e trupit të përdoruesit. Ndenjësja duhet të jetë e prodhuar nga dru i presuar kompensatë me trashësi 12mm, shkume poliuretani trashësi 40 mm, e cila është e veshur me tapiceri dhe rrjetë. Pjesa e sipërme e shpinores te jete e veshur me tapiceri ose lëkure ekologjike ndërsa pjesa e poshtme me rrjete. Përmasat gjatësi 740 mm dhe gjerësi 465 mm (me shpinë të lartë) ose gjatësia 580 mm dhe gjerësia 465mm(me shpinë të lartë me rrjetë dhe lëkurë ne krye). Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 	60 x 40 x 80 cm	Copë
----	---------------------------	---	-----------------	------

92	Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 12 persona	Syprina MDF, jo e shkëlqyeshme pa venatura druri me trashësi 4 cm, me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë inox. Bordet anësore të planit të punës të jenë të harkuara. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë, që i jep tavolinës pamje solide. Aksesoret që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	320 cm x 140 cm x 75 cm	Copë
93	Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 6 persona	Syprina MDF, jo e shkëlqyeshme pa venatura druri me trashësi 4 cm, me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë inox. Bordet anësore të planit të punës të jenë të harkuara. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë, që i jep tavolinës pamje solide. Aksesoret që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	240 cm x 120 cm x 75 cm	Copë
105	Tavolinë klase	Skeleti me strukturë metalike. Këmbët janë prej çeliku dhe janë të pajisura me këmbëza niveluese. Ato lidhen me njëra tjetrën me traversa të po të njëjtit material. Në pjesët ballore tavolina mund të mbulohet me panele melamine me gjerësi jo më të vogël se 16 cm dhe trashësi 1.6 cm. Të gjitha pjesët metalike janë të lyera me bojë elektrostатike me qëndrueshmëri të lartë ndaj ndryshkjes dhe gërvishtjeve. Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të syprinës të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015: SSH EN 1729-2:2012 +A1:2015	180 x 60 x 75 cm	Copë
110	Tavolinë mence	Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të syprinës të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Mbështetet në 4 këmbë prej çeliku të cilat janë të pajisura me këmbëza niveluese. Ato lidhen me njëra tjetrën me traversa të po të njëjtit material. Të gjitha pjesët metalike janë të lyera me bojë elektrostатike me qëndrueshmëri të lartë ndaj ndryshkjes dhe gërvishtjeve. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015: SSH EN 1729-2:2012 +A1:2015	80 x 80 x 75 cm	Copë


113	Tavolinë e vogël mesi, drejtuesi	Strukturë me tuba cilindrik çeliku me sipërfaqe të lëmuar, të kromuar dhe ku është montuar paraprakisht me shpim, me vrima të padukshme nga jashtë syprina MDF, me shtresë të jashtme laminat të plastifikuar, të niveluar dhe të palëvizshme. Mbështetja e strukturës në dysheme, duhet të ketë katër tapa plastike për të mundësuar përdorimin, mos dëmtimin e dyshemesë përkatëse (si, psh. nga gërvishtjet) dhe të zbusë rrëshqitjen pa shkaktuar zhurma. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	Përmasat e tavolinës të jenë jo më pak se 53 x 48 x 43 cm ku lartësia nuk duhet të kalojë 43cm	Copë
115	Tavolinë zyre	Tavolina e punës përbëhet nga syprina prej materiali melaminë me trashësi 2.5 cm me borde anësore të plastifikuara me PVC 0.8 mm. Dy anësoret dhe harku lidhës përbëhen nga materiali melaminë me trashësi 1.8 cm. Bashkimi i elementëve të tavolinës së punës bëhet me aksesore të padukshëm. Tavolina e punës mbështetet mbi këmbë plastike po ashtu skeleti i tavolinës së kompjuterit përbëhet nga melaminë me trashësi 1.8 cm njësoj si pjesa tjetër dhe poshtë tavolinës vendoset një pjesë për mbajtjen e tastierës së kompjuterit. Komodina mbështetet mbi rrota dhe ka tre sirtarë me doreza të hapshëm me shina ku sirtari i parë detyrismisht duhet të ketë edhe bravë. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	<i>Tavolinë pune</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 120 x 70 x 72 cm <i>Tavolinë kompjuteri</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 90 x 70 x 72 cm Hark Lidhës 70 x 70 x 72 cm <i>Sirtarë komode</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 40 x 42 x 62 cm	Copë
116	Tavolinë pune	Syprina melaminë me trashësi 32 mm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide dhe të rëndë. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesoret që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	180 x 80 x 75 cm	Copë

				
118	Tavolinë pune e thjeshtë	Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në pjesën e brendshme në njërin krah ndodhet posti i tastierës e fiksuar me shina rrëshqitëse, në krahun tjetër ndodhen dy sirtarë me gjerësi 45 cm ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës. Montimi i tastierës duhet të jetë i thjeshtë dhe me mundësi zgjedhje të krahut të punës. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	140 x 80 x 75 cm	Copë
123	Tavolinë pune e thjeshtë në formë L-je	Tavolina e punës: Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminate me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide dhe të rëndë. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesorët që përdoren për montimin e elementeve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bënë të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Tavolina e kompjuterit: Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminate me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me	<i>Tavolinë pune</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 140 x 80 x 75 cm; <i>Tavolinë kompjuteri</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 90 x 80 x 75 cm; <i>Hark lidhës</i> 90 ° me përmasa: 80 x 80 cm	Copë

		këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide dhe të rëndë. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesoret që përdoren për montimin e elementeve të tavolinës të jenë cilësor. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bënë të mundur kalimin e kabllave nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Në pjesën e brendshme ka postin e tastierës të fiksuar me shina rrëshqitëse. Harku lidhës: Materiali dhe karakteristikat janë të njëjta me tavolinën e punës dhe të kompjuterit. Bënë të mundur lidhjen organike të tavolinës së punës me tavolinën e kompjuterit. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004		
125	Tavolinë drejtuesi në formë L-je e madhe	Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminate me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me material melamine trashësi 18 mm. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesoret që përdoren për montimin e elementeve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Tavolina e punës në pjesën e brendshme ka të montuar në njërin krah një bllok sirtarësh ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	<i>Tavolinë pune</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 140 x 70 x 72 cm <i>Tavolinë kompjuteri</i> 90 x 70 x 72 cm <i>Hark Lidhës</i> 90 gradë me përmasa 70 x 70 cm <i>Tavolina e mbledhjes</i> 130 x 70 x 75 cm	Copë
126	Tavolinë drejtuesi në formë L-je e vogël	Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminate me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me material melamine trashësi 18 mm. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesoret që përdoren për montimin e elementeve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Tavolina e punës në pjesën e brendshme ka të montuar në njërin krah një bllok sirtarësh ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	<i>Tavolinë pune</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 140 x 70 x 72 cm <i>Tavolinë kompjuteri</i> 90 x 70 x 72 cm <i>Hark Lidhës</i> 90 gradë me përmasa 70 x 70 cm	Copë

134	Tavolinë me palosje	Tavolina e punës duhet të ketë syprinë të realizuar në melaninë, trashësia e syprinës 30 mm, struktura e brendshme aglomerat i veshur me melamine antirefleks, kundra gërvishtjes dhe rezistente ndaj lagështirës, e borduar në të 4 anët me ABS kundra përplasjes me spesor 2 mm. Këmbët e tavolinës të jenë të ndërtuara me një strukturë të lehtë metalike duhet të jetë e realizuar me 2 tuba çeliku diametër minimal 3cm, të cilët vendosen vertikalisht midis 2 bazave të sipërme dhe të poshtme. Baza e poshtme përfundon në skaje me 2 çifte rrotash, baza e sipërme lidhet me suportin e syprinës së tavolinës, me anë të një mekanizmi metalik që lejon palosjen. Tavolinat duhet të jenë të pajisura me rrotëza të lëvizshme 360° me sistem bllokimi. Struktura metalike të jetë e gjitha e lyer me pluhura epoksidike në ngjyrë alumini. Struktura mbajtëse e tavolinës duhet të jetë me palosje vertikale, për të krijuar lehtësi në lëvizje dhe në sistemim për kursim vendit të magazinimit pas përdorimit. Sistemi që realizon palosjen e tavolinës duhet të jetë i montuar poshtë syprinës dhe të jetë me dy gaxha tërheqëse. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	140 x 70 x 72,5 cm	Copë
138	Krevat tek	Materiali i përdorur do jetë melamine me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të elementëve përbërës të jenë të rrethuara veshura me material plastik PVC. Krevati do të jetë i pajisur me radice druri të stazhonuar për mbajtjen e dyshekut. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1334:1996	Krevati 190 x 90 cm; Koka e krevatit me përmasa: 80 x 90 cm; Fundi i krevatit me përmasa: 40 x 90 cm	Copë



143	Varëse rrobash (koke prifti) metalike	Varësja duhet të jetë komplet metalike. Konstruksioni qendror i trupit të varësës duhet të jetë metal me diametër 2.8-3 cm, ndërsa degëzimet mbajtëse duhet të jenë me diametër minimal 2 cm dhe skajet e tyre të punuara me gdhendje rrethore. Varësja ne lartësinë 60-70 cm duhet të ketë edhe mbajtësen e çadrave ne formën e një strukture rrethore metalike. Varësja duhet te jetë e pajisur me 8- 10 mbajtëse anësorë.	Gjatësia 180 cm, diametri i bazamentit 43 cm	Copë
				
		Dy panele druri të lehtë (paulania, ose zdrukthi), orientimi horizontal, me përmasa secila 90 x 220 cm, të kapura në brinjën e ngushte me 2-3 mentesha metalike estetike, dhe të montuara me hapje/kënd 15 gradë me njëra-tjetrën, dhe të lidhura në bazament për qëndrueshmëri. Secili panel ka të montuar 4 xhepa horizontale (90 cm të gjatë dhe 12 cm të gjerë) të vendosur me 50 cm largësi njëri nga tjetri gjatë gjithë lartësisë së panelit.	90 x 220 cm	Copë
156	Ekspozitorë			

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Operatori ekonomik fitues do të kryejë transportin dhe montimin e mallrave objekt prokurimi në vendin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

LOTI 2 "BLERJE PAJISJESH"

Specifikimet teknike për pajisjet janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Komanda Mbështetëse.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PAJISJEVE

Televizor LED madhesia 70-75"	MARKA - sipas tregut; Televizor LED, Nga 70 - 75", 4K ULTRA HD 3840 x 2160, Smart, DVB-T2/C/S2, CL+, HDMI / USB, W167.8xH102.7xD33.9 cm, 2 vjet garanci	<i>Televizor LED,,= 70-75 " 2 vjet garanci</i>
Televizor LED madhesia 40-45"	MARKA - sipas tregut; -Televizor LED, =Nga 40-45", 4K ULTRA HD 3840 x 2160, Smart, DVB-T2/C/S2, CL+, HDMI / USB, W114.3xH56xD33.9 cm, 2 vjet garanci	<i>Televizor LED,, = 40-45 " 2 vjet garanci</i>
Frigorifer banak (100-130) L	Te dhenat teknike: niveli zhurmes: 38 dB (A), Gjerësia: deri 55 cm, Ndërrimi i krahut të derës: N/A, Mënyra e ftohjes: Me ngrirje, Kapaciteti ftohës: N/A, Lartësia: deri 85 cm, Klasi i energjisë: A+/F, Thellësia: deri 50 cm, Tensioni: 220-240 V, Shpërndarës uji: Jo, madesia deri 100-110 litra, 2 vjet garanci	<i>Dimensionet (WxDxL): 55x48x84 deri ne 100-130 L</i>
Frigorifer i mesem normal (100-150) L	Gjeneral Marka: sipas tregut Gjeresia: deri60 Lartesia: 150 Thellesia: 55 Tipi i Frigoriferit: NGRIRES I SIPERM Ngjyra/Materiali: GRI / INOKS Lloji i ftohjes: ME AKULL Kapaciteti gjithsej: 120-217 Zona e Freskise: - - Paneli i kontrollit: - Opsione Ekstra: JO, Klasi i energjisë: A+/F, NIVELI I ZHURMËS: 38 dB (A), 2 vjet garanci	<i>Dimensionet (WxDxL): 55cmx48x150 deri ne 100-150 L</i>
Kondicioner 12 000BTU	Të dhënat teknike te peraferta: Energjia elektrike Ph-V-Hz 220-240V-50Hz, 1Ph, Ftohje: Kapaciteti Btu/h 12000 Hyrje W 1095,Korenti A 4.9 EER 3.21, Ngrohja:Kapaciteti Btu/h 12500, Hyrje W 1015, Korenti A 4.5, COP W/W 3.32, Qarkullimi ajrit brenda (Hi/Mi/Lo) m3/h 580/5000/400, Niveli zhurmes brenda Hi/Mi/Lo) 41/38/35, Hyrja qendrore: Dimensioni (W*D*H) mm 790*196*275, Paketimi (W*D*H) mm 865*265*350, Pesha neto kg 8/10, Dalja e ajrit m3/h 1800, Niveli zhurmes jashte dB (A) 54, Njesia jashtme: Dimensioni (W*D*H) mm 780*250*40, Paketimi (W*D*H) mm 910*335*585, Pesha neto kg 26/28., Lloji antipiretik g 410A/760g, Antipiretik i mbrehte: Gazi mm (inch) ϕ6.35/ϕ12.7 (1/4"/1/2"), Gjatesia e tubit antipiretik m 20, Diferenca e nivelit m 8, Temperatura: Ngrohje/ftohje (brenda) oC17-30, Ngrohje/ftohje (jashte) oC 18-43/-7-24	<i>Kapaciteti Btu/h 12000, Garancia 2 vite</i>

Kondicioner 18 000BTU	Të dhënat teknike te peraferta: Energjia elektrike Ph-V-Hz 220-240V-50hZ, 1Ph, Ftohje: Kapaciteti Btu/h 18000(5100-22000), Hyrje W 1640(380-2300), Korenti A 7.2 (1.8-10.2), EER 3.21, Ngrohja:Kapaciteti Btu/h 18500(5300-23000), Hyrje W 1500(350-2000), Korenti A 6.6 (1.6-19), COP W/W 3.61, Qarkullimi ajrit brenda (Hi/Mi/Lo) m3/h 600/480/400, Niveli zhurmes brenda Hi/Mi/Lo) 45/42/38, Hyrja qendrore: Dimensioni (W*D*H) mm 930*198*275, Paketimi (W*D*H) mm 1015*265*350, Pesha neto kg 10/13.5, Dalja e ajrit m3/h 2200, Niveli zhurmes jashte dB (A) 54, Njesia jashtme: Dimensioni (W*D*H) mm 760*285*590, Paketimi (W*D*H) mm 887*355*645, Pesha neto kg 37.5/39, Lloji antipiretik m 20, Antipiretik i mbrehte: Gazi mm (inch) $\phi 6.35/\phi 12.7$ (1/4"/1/2"), Gjatesia e tubit antipiretik m 20, Diferenca e nivelit m 8, Temperatura: Ngrohje/ftohje (brenda) oC17-30, Ngrohje/ftohje (jashte) oC 0-15/-15-34	<i>Kapaciteti Btu/h 18000 Garancia 2 vite</i>
Mikrovale e thjeshte	Funksionimi: Ngrohje, Kapaciteti: 20-25 l, Komandimi: Elektronik, Fuqia e mikrovalës: 700-1000 Watt, Qendrimi: I lirë, Garancia: 24 muaj	<i>Garancia 2 vite</i>

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Operatori ekonomik fitues do të kryejë transportin dhe montimin e mallrave objekt prokurimi në vendin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT